Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

⁴ Kjo deklaratë ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënktraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

a. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

a. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit duhet të mos jete me e vogel se 50 % e fondit limit. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve e fundit.

b. Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate tre viteve 2017, 2018 dhe 2019, qe do te thote: OE të paktën të mos ketë bilanc me humbje në 2 vite të njëpasnjëshme. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të ketyre tre viteve, të paraqitura e konfirmuara nga autoriteti përkatëse, te shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar në përputhje me ligjin anr.10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesi tligjor dhe kontabilistit të miratuar”

c. Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2019, 2020 sipas afateve te percaktuara ne ligjin 9632/2006 ” Per sistemin e taksave vendore ”, i ndryshuar. Kesaj deklarate duhet ti bashkengjiten te gjitha vertetimet qe deshmojne se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet perkatese**, ne vendet ku ka ushtruar aktivitetin sipas QKR-se.

d. Në zbatim të Ligjit Nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, si dhe të njoftimit të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe APP, respektivisht me Nr.

25366 Prot dhe Nr.8480 Prot, datë 30.12.2020, te njoftimi i kontratës, në seksionin “Shënime të tjera”, AK ju informon operatorët ekonomikë që për nënshkrimin e kontratës publike, në përfundim të procedurës, duhet të kenë:

- Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformen Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen softëere-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softwar-ike"

2.3 Per kapacitetin teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se 200 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

2.3.1/aPër kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vleresimit;
2. Kontratën/Kontratata;
3. Situacionin përfundimtar si dhe situacionet progresive/pjesore;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikaten/certifikatat e marrjes ne dorezim;

2.3.1/bPër kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vleresimit
2. Kontrate;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt kolaudim i objekti;
5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të deshmojnë se disponojnë license profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës.

Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008; *Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.*

Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

1. NP 1 - A;
2. NP 2 - A;
3. NP 7 - B;
4. NS 4 – A;
5. NS 16 - A;
6. NS 18- A;

Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjes;

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturaes, Republika e Shqipërisë, sic percaktohet ne *Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008.*

2.3.3 AK duhet të mbajë në vëmendje përcaktimet e pikës 1, të nenit 46 të LPP dhe pikës 5, të nenit 26, të VKM nr.914, datë 29.12.2014, që cdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës dhe faktin se, vendosja e këtij kriteri mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish se ai i vendosur në këtë kriter. OE mund ta disponojnë, duke patur parasysh edhe përcaktimet e nenit 11, gërma a), të ligjit “Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet se pagesat e kontributeve bëhen: “*Nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër*”. Per te provuar se ka pervoje e duhur , Operatori duhet te deshmoje se ka te punesuar mesatarisht të paktën 200 punonjes me, për periudhën gusht 2020– janar 2021 të deshmuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj ne periudhen e mesiperme.
- b. List pagesat e punonjesve te plotesuar rregullisht sipas formatit e percaktimeve qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per secilin nga muajt ne periudhen e mesiperme

2.3.4 Operatori duhet te deshmoje se ka drejtues teknik qe do te angazhohet per realizimin e punimeve stafin e meposhtem:

a.Stafi i drejtuesve teknik i shoqerisë të ketë në përbërje:

- Inxhinier ndertimi : 3 punonjes
- Inxhinier ndertimi (strukturist): 1 punonjes
- Arkitekt : 1 punonjes
- Inxhinier elektrik : 1 punonjes
- Inxhinier mekanik : 1 punonjes
- Inxhinier topograf: 2 punonjes
- Inxhinier gjeolog : 1 punonjes

Dokumenta Standarde të Tenderit

- Inxhinier hidroteknik : 1 punonjes
- Inxh. Mjedisi me certificate per vleresimin e demeve ne mjedis : 1 punonjes

Per secilin prej pjesëtareve të stafit duhet të paraqitet:

- kontratë pune e vlefshme
- diploma
- CV

b. Operatori Ekonomik duhet te kete ne përbërje te stafit mjek ne përputhje te plote me VKM nr. 632, date 15.07.2015, i ndryshuar. Per kete duhet te paraqese diplomën, kontratë noteriale pune, urdherin e mjekut dhe CV-ne, dhe te figurojne ne list –pagesat per periudhen (Gusht 2020 - Janar 2021) dhe të figurojë në listëpagesat e shoqerise OSE po nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë . 1 (një) mjek të përgjithshëm. Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomike secili duhet te kete te punesuar nje mjek te pergjithshem.

c. Operatori ekonomik duhet të ketë në staf 1 (një) ekspert zjarrefikes të certifikuar.

Per te cilin te paraqitet kontrata noteriale e punës , CV, Libreze pune , certifikata e ekspertit dhe te figurojne ne list –pagesat per periudhen (Gusht 2020 - Janar 2021)

d. Operatori duhet që 1 (nje) nga drejtuesit teknik te shoqerise , ose cdo punonjws I shoqwrise , të disponojë çertifikate të specializimit per IRI (internatational roughnes index) & FWD (falling weight deflectometer)”

Krahas stafit te mesiperm te kete te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

- 1 inxhinier ndertimi;
- 1 inxhinier mekanik;
- 1 inxhinier elektrik
- 1 inxhinier hidrotekenik
- arkitekthe restauratore me licence personale per Projektim dhe zbatim ne restaurimin e monumenteve te trashegimise se arkitektures : 1 punonjes

Operatori ekonomik te paraqes per inxhinieret e mesiperm kontrate te punes te vlefshme ,diplome,cv.

1 (nje) nga inxhinieret pjese e drejtuesve teknik te shoqerise, **ose** cdo punonjws I shoqwrise , duhet te jete i pajisur me certifikaten te Trajnimit për ”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune” për realizimin e objektit të kontratës.

- **1(nje)** nga inxhinieret pjese e drejtuesve teknik te shoqerise duhet te jete i pajisur me certifikaten per “*Ndihmen e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave*”, **ose** cdo punonjws I shoqwrise , i cili duhet te figuroje ne listepagese.

e. Krahas stafit te mesiperm te kete te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

Operatori ekonomik duhet të kete te punesuar dhe te figurojne ne listpagesat e subjektin per te pakten vitin e fundit punonjesit specialiste te kualifikuar te pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit Teknik nga ISHTI ose nga autoritete ekuivalente te akredituara dhe kontrate pune te vlefshme, punonjesit si me poshte:

Dokumenta Standarde të Tenderit

- Elektracist_4_punonjes
- Bojaxhi_2_punonjes
- Hidraulik_5_punonjes
- Karpentier_5_punonjes
- Hekurkthyer_3_punonjes
- Saldator_2_punonjes
- Hidroizolues_2_punonjes
- Mekanik_5_punonjes
- Teknik Ndertimi_3_punonjes
- Pllakashtrues_2_punonjes
- Teknik -Mekanik_2_punonjes
- Teknik Gjeometer_3_punonjes
- Elektromekanik_1_punonjes
- Inxhinier elektrik (Grupi V) 1 punonjes
- Betonues_2_punonjes

Nga punonjesit e mesiperm pervec deshmise se kualifikimit te sigurimit Teknik , minimalisht duhet te jene te pajisur me deshmi te aftesimit profesional nga institucionet e akredituara te formimit profesional ose diploma, me nje eksperience jo me pak se 6 mujore nga diplomimi, punonjesit e meposhtem:

- Elektracist_4_punonjes
- Hidraulik_4_punonjes
- Karpentier_5_punonjes
- Saldator_2_punonjes
- Mekanik_1_punonjes
- Teknik Ndertimi_3_punonjes
- Pllakashtrues_2_punonjes
- Teknik Gjeometer_3_punonjes
- Elektromekanik_1_punonjes

f. .Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 punonjës Eskavatorist, 2 punonjës Buldozerist si dhe 3 punonjës Automakinist për të cilët duhet të paraqitet: kontrata e punës (e vlefshme), Deshmi e Aftesise Profesionale (e vlefshme) ose Leje Manovrimi lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për (Tetor 2020 - Janar 2021), dhe te jene te pajisur me Deshmi te kualifikimit te sigurimit Teknik.

Për punonjësit e sipërpërmendur të paraqiten kontratat e punës të vlefshme, dëshmite e aftesimit profesional dhe dëshmite e drejtimit (të vlefshme). Specialistet e mesiperm duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise te pakten 3 muajt e fundit nga data e hapjes se tenderit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

- a) ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit te Cilesise);
- b) ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurise ne Pune);

Dokumenta Standarde të Tenderit

- c) ISO PAS 99:2012 (Per sistemin e integruar te menaxhimit)(ose e perditesuar);
- d) ISO 3834-2:2006 (Kerkesat e cilesise per saldimin e materialeve elektrike)
- e) ISO 1452-1: 2009 (Sistemet e tubacioneve plastike per furnizimin me uje kullimet dhe kanalet nentokesore dhe mbitokesore nen presion)

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë përkatësisht Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Duke marrë në konsideratë se AK në kërkesën e certifikatës i është referuar vetëm standardeve EN, në kuptim të:

-nenit 23 të LPP, pika 3/a, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;
-faktit që ekzistojnë standarde ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.

AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN, mbi komformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Te gjitha certifikata e mesiperme duhet te jene te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit,i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizman ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.6 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1.	Eskavator me zinxhir	Copë	7	Në pronësi ose me qera
2.	Eskavator me goma	Copë	4	Në pronësi ose me qera
3.	Eskavator me zinxhir gome	Copë	4	Në pronësi ose me qera
4.	Fadroma	Copë	2	Në pronësi ose me qera
5.	Grejder	Copë	3	Në pronësi ose me qera
6.	Kamion vetshkarkues (min 20 ton)	Copë	6	Në pronësi ose me qera
7.	Kamioncina kapaciteti 1 deri ne 1.5 ton	Copë	4	Në pronësi ose me qera
8.	Gurethyses frontoje	Copë	1	Në pronësi ose me qera
9.	Impiant betoni dhe asfalti	Copë	1	Në pronësi ose me qera
10.	Vibrator betoni	Copë	4	Në pronësi ose me qera
11.	Vibrator ngjeshes	Copë	1	Në pronësi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

12.	Asfalto shtruese	Copë	2	Në pronësi ose me qera
13.	Rrule gome hekur	Copë	4	Në pronësi ose me qera
14.	Rrule cilinder cilinder	Copë	3	Në pronësi ose me qera
15.	Rrul me gunga	Copë	1	Në pronësi ose me qera
16.	Rrul asfalto gome -hekur min. 3.5 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
17.	Auto Betoniere	Copë	3	Në pronësi ose me qera
18.	Autovinc	Copë	3	Në pronësi ose me qera
19.	Mjet kulle	Copë	1	Në pronësi ose me qera
20.	Buldozer	Copë	3	Në pronësi ose me qera
21.	Kompresor	Copë	3	Në pronësi ose me qera
22.	Saldatrice	Copë	5	Në pronësi ose me qera
23.	Sharre asfalto	Copë	3	Në pronësi ose me qera
24.	Tomak Elektrik	Copë	4	Në pronësi ose me qera
25.	Pompe Suvatimi	Copë	2	Në pronësi ose me qera
26.	Minifadrome	Copë	2	Në pronësi ose me qera
27.	Autobot uji me sprucator	Copë	1	Në pronësi ose me qera
28.	Vinc Karel	Copë	2	Në pronësi ose me qera
29.	Nivelues betoni helicopter	Copë	1	Në pronësi ose me qera
30.	Matrapik	Copë	3	Në pronësi ose me qera
31.	Depozita uji 5000 l	Copë	16	Në pronësi ose me qera
32.	Pompe uji	Copë	10	Në pronësi ose me qera
33.	Gjeneratore	Copë	9	Në pronësi ose me qera
34.	Trapan dore	Copë	10	Në pronësi ose me qera
35.	Palankola	ton	205	Në pronësi ose me qera
36.	Pajisje per largim te ujrave nentokesore me sistemin gjilperthithese (Well Point)	Copë	3	Në pronësi ose me qera
37.	Makineri per nxjerrje kolonash profile metalike/palankolash	Copë	1	Në pronësi ose me qera
38.	Sistem makinerie e drejtuar me lazer per realizim mikrotyneli me Ø (250-1000) mm	Copë	1	Në pronësi ose me qera
39.	Cekic vibrues	Copë	1	Në pronësi ose me qera
40.	Pajisje per matje IRI &FWD	Copë	1	Në pronësi ose me qera
41.	Pajisje bashkimi tubash PE me Elektrofuzion	Copë	5	Në pronësi ose me qera
42.	Pajisje saldimi per bashkim nyjesh me elektrofuzion	Copë	7	Në pronësi ose me qera
43.	Pajisje per testimin e presonit te tubave deri ne 40 bar	Copë	4	Në pronësi ose me qera
44.	Autobot nafte	Copë	1	Në pronësi ose me qera
45.	Autobitumatrice (pajisur me certifikate per transport lendesh te rrezikshme)	Copë	1	Në pronësi ose me qera

3.Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 40 (dyzete) copë
 - Jelekë minimumi 40 (dyzete) copë
 - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 (pesë) copë
 - Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 20 (njezete) copë
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 (pese) copë
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit:
 - çertifikatën e pronësisë;
 - leja e qarkullimit;
 - çertifikatën e kontrollit teknik;
 - siguracionin;
 - taksat vjetore
 - leja e transportit që leshohet nga njesia vendore;ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në perfundimin e plotë të punimeve.
 - Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në perfundimin e plotë të punimeve.
 - Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë mbi vendodhjen e mjeteve.
 - Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. Deklaratë nga administrator i shoqërisë ofertuese.
 - Deklaratë nga administratori i shoqërisë që informacioni dhe dokumentet e paraqitura në tender janë të sakta dhe nuk përmbajnë informacion të rreme, për penalizim konform parashikimeve të nenit 13 të LPP.

2.3.7 Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë, në çfarëdo lloji kapaciteti. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër do të rezultojë në përjashtimin nga procesi i të gjithë ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi. (Kreu V-të, pika 4/b/1 të Rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar).

2.3.8 Operatorët e huaj ekonomik, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën **shqipe (si gjuhë e ofertes)**, për të gjithë përmbajtjen e dokumentit, të bëjnë noterizimet perkatese si dhe të jenë **te certifikuara “Apostille”**. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hages, datë 5 tetor 1961, “*per heqjen e kërkeses për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja*”, duhet të behen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrtarë respektive nga vendi i origjinës. (mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues).

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzoj analizë teknike për të gjithë e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim. Bazuar në VKM Nr.514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10.

2.3.10 Grafiku i punimeve, ku zërat e punës, fuqisë punëtore dhe numrit të mjeteve të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të jetë e pajisur me licencat e lëshuara nga QKL si me poshtë:

- a. Licenca për per sherbime ekspertize dhe / ose profesionale lidhur me pyje dhe / ose kullota, kodi **III.7.A**
- b. Licencë për per sherbime ekspertize te mbrojtjes civile kodi **kodi 1.2.A**
- c. Liçense për sherbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis.Veprimtari specifike :1.Ndikim ne mjedis,
- d. Liçense për Transportim I mbetjeve te parrezikshme **kodi III.2.B**
- e. Licence nga Keshilli Kombetar I Restaurimit:Licence ne zbatim Kategoria CZ:Zbatim per punimet e restaurimet ne monumentet e arkitektures per shoqeri ndertimi

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[*Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës*]

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomike më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Dokumenta Standarde të Tenderit

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS **Punët – Procedura e Hapur**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha

Dokumenta Standarde të Tenderit

bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore

ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

